

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Iirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit M. Z. nga Gjakova, për shkak të veprës penale uzurpim i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore –DP në Gjakovë, PP.nr. 1717/13 të datës 04.02.2013, në shqyrtimin publik gjyqësor, të mbajtur më datë **25.01.2017**, në prani të Prokurorit së shtetit Ramiz Buzhala, te dëmtuarës B. Z. , përf. të autorizuar V. A. av. në Gjilan dhe të akuzuarit M. Z., me dt. 27.01.2017 morri këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **M. Z.**, i lindur më dt..., në Gjakovë, Rr... i biri i K. dhe i nënës S., e gjinisë B., ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike, shfrytëzues i ndihmave sociale, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, i martuar.

Ë s h t ë f a j t o r :

Sepse:

-nga periudha e pas luftës e këndeje, në mënyrë të kundërligjshme e ka uzurpuar pronën e paluajtshme, përkatësisht banesën e dëmtuarës Z. B., e cila banës është në sipërfaqe te përgjithshme prej 39.97m², lokacioni “Orize 11” kat.IV, ashtu qe te njëjtën paluajtshmëri i pandehuri M. e shfrytëzon dhe e mban ne uzurpim pa asnjë baze ligjore .

- me çka ka kryer veprën uzurpim i paligjshëm i pronës se paluajtshme nga neni 332/1 KPRK-ës.

Andaj Gjykata në bazë te nenit 4,41,49,50,51,73 dhe nenit 332/1të KPRK-ës dhe nenit 365 të KPP, të akuzuarit M. Z., i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Dënim me burgim në kohëzgjatje **prej 6(gjashtë) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1(një) viti** , nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Detyrohet i akuzuari që të lirojë banesën – paluajtshmerinë e cila ndodhet ne lokacionin “Orize 11” kat. IV, në sip. 39.97m², dhe e njëjta ti dorëzohet pronarit Z. B. nga Gjakova ,në afat prej **15 ditëve**, pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë, konform nenit 69 të KPRK-es.

E dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest civil .

Shpenzimet e procedurës penale bien ne barrën e mjeteve buxhetore te Gjykatës

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.1717/13 të dt.04.02.2015, e ka akuzuar të akuzuarin M. Z. nga Gjakova, për shkak të veprës penale uzurpim i paligjshëm i pronës se paluajtshme nga neni 332/1 të KPRK-së, duke propozuar që ndaj të akuzuarit ti shqiptohet Urdhër ndëshkimor, me të cilën do ti shqiptohet dënimi me gjobë. Gjykata ka aprovuar Propozimin e Prokurorisë Themelore dhe me Aktgjykim me P.nr. 84/15 të dt.20.04.2015, të akuzuarin e ka shpallur përgjegjës dhe e ka dënuar me gjobë me 300 ,oo.-Euro i njëjti është e obliguar që të paguaj shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 30 euro, krejt këtë në afat prej 15 ditësh nën kërcenim të përmbartimit me dhunë. Në afatin ligjor i akuzuari ka parashtruar kundërshtim me dt.24.04.2015 kundër urdhër ndëshkimor me nr.P.nr.84/15 të datës 20.04.15, për çka edhe është caktuar shqyrtimi gjyqësor.

Në shqyrtimin gjyqësor dhe publik të mbajtur me dt. 25.01.2017, përfaqësuesi i Prokurorisë Themelore DP në Gjakovë, prokurori Ramiz Buzhala, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë aktakuzës PP.nr. 1717/13 dt. 04.02.2015. Në fjalën përfundimtare deklaroi se paraprakisht beje precizimin e dispozitivit të aktakuzës ashtu që në dispozitiv në rreshtin e III të duhet të shtohet pas fjalës në sip. Prej 39.97 m katror , lokacioni “Orize “11 ,ka.IV , ndërsa pjesa tjetër mbetet e pandryshuar . Edhe gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor, në veçanti pas procedurës së provave u vërtetuar se i akuzuari M. Z. ka kryer veprën penale uzurpim i pronës se paluajtshme nga neni 332/1 të KPRK-ës të kryer si në aktakuzë, gjendja e tillë faktike u vërtetua në tërësi nga dëgjimi i të dëmtuarës në cilësi të dëshmitares e cila në dëshminë e vetë para gjykatës edhe njëherë vërtetoi se që nga data e largimit nga banesa në vitin 1999 me të akuzuarin nuk ka arritur asnjëherë asnjë lloje marrëveshje për shfrytëzimin e kësaj paligjshmërie-banese, dhe përkundër gatishmërisë së blerësve tjerë për këtë banesë dhe gatishmërisë së saj për shitje të banesës , e njëjta një gjë e tillë nuk ka mundur ta arrijë pasi që pengese ka qenë këtu i akuzuari M. Z., i cili nuk ka lejuar një gjë të tillë, pastaj nga provat materiale siç është vendimi i Habitatit nr. HPCCDS302633, dt.27.06.2003, dhe vendimi me nr. të njëjtë i dt. 18.02.2006, vërtetohet se këtu i akuzuari është dëbuar nga kjo banesë me pretekst se i njëjti në të qëndron pa asnjë baze juridike, të cilën gjë edhe vetë i pandehuri këtu para gjykatës deklaroi se pasi banesa është mbyllur nga Habitatit në mungesë të bazës së vlefshme juridike për shfrytëzim i njëjti pas 2-3 ditësh pasi ka thyer bravën është vendosur në këtë banesë ku qëndron edhe sot e kësaj dite , edhe pse me pronarin legjitim nuk ka asnjë lloje marrëveshje për shfrytëzim. Andaj për këto arsye të akuzuarin e konsiderojë përgjegjës dhe i propozoi gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor dhe dënojë sipas ligjit. Gjithashtu i propozoi gjykatës që ndaj të njëjtit të merr parasysh të gjitha rrethanat renduese dhe lehtësuese të parapara me dispozitat e KPRK-ës, që në rastin konkret si rrethane renduese të merret kohëzgjatja e shfrytëzimit të kësaj paluajtshmërie si dhe qëndrimi jo korrekt ndaj palëve në gjykim . Gjithashtu i propozoi gjykatës që konform nenit 69 të KPRK-ës ti shqiptohet masa , marrja e sendit e që këtu është lirimi nga banesa dhe kthimi pronarit legjitim .

Perf. i autorizuar i të dëmtuarës, av. V. A., në fjalën përfundimtare deklaroi se në tërësi e mbështesim fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit dhe të gjitha propozimeve të tij të cekura në fjalën përfundimtare ,por mbesim në tërësi pranë kërkesës pasurore juridike. Kërkojë nga gjykata që të akuzuarin ta detyrojë ta lirojë paluajtshmerin e cekur menjëherë. Kjo pasi që i akuzuari gjatë shqyrtimit kryesor është treguar i rreptë ndaj të dëmtuarës dhe me paramendim direkt ka shkuar në kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barre, çka edhe vetë ka pranuar në mbrojtjen e vetë përkundër vendimit të plotfuqishëm të Habitatit , i njëjti prapë kryen veprën penale duke i shkaktuar demin dhe dhimbjen këtu të dëmtuarës se po të kishte shitur me kohë banesën do të ishte me e shëndetshme, këto prova vetë gjykata është bindur duke parë shëndetin e të dëmtuarës. Mungesa e rrethanave lehtësuese këtu të akuzuarit propozoi që dënimi i gjykatës të jete konform ligjit të Kosovës, që e njëjta të ndikojë tek i akuzuari.

E dëmtuara Z. B. ne fjalën përfundimtare deklaroi se e mbështet ne tërësi fjalën përfundimtare te perf. te autorizuar V. A.

I akuzuari M. Z., ne fjalën përfundimtare deklaroi se nuk e konsideron veten fajtores për veprën penale me te cilën akuzohet , me qene se siç kam cekur në kundërshtim, banesa në fjalë na është lëshuar nga ana e vet të dëmtuarës e cila ia ka lënë çelësin e banesës, të cilën banesë akoma e kemi në shfrytëzim në pamundësi të vendstrehimit tonë, gjithashtu shtoj se edhe pas dëbimit nga Habitatit bashkëshortja ime ka komunikuar në telefon me të dëmtuarën e cila i ka thënë se nuk ka kush punë me banesën time dhe për këtë arsye jemi kthyer në banës. I propozoi gjykatës qe te merr aktgjykim qe te lirohem nga akuza.

Duke qene se i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë gjykata ne kuptim te nenit 326/1 te KPP-ës, ka vendosur qe seanca e shqyrtimit gjyqësor te vazhdojë me prezantimin e provave.

Gjate shqyrtimit gjyqësor me rastin e procedimit te provave dhe vlerësimit te tyre, një nga një e ne lidhje me njëra tjetrën komfor nenit 361 te KPP-ës, Gjykata vlerësoi këtë gjendje faktike.

Se i akuzuari qe nga periudha e pas luftës e këndeje, në mënyrë të kundërligjshme e ka uzurpuar pronën e paluajtshme, përkatësisht banesën e dëmtuarës Z. B. e cila banës është në sipërfaqe te përgjithshme prej 39.97m², lokacioni “Orize 11” kat.IV ,ashtu qe te njëjtën paluajtshmeri i pandehuri M. e shfrytëzon dhe e mban ne uzurpim pa asnjë baze ligjore .

Këtë gjendje faktike gjykata e vërtetojë nga provat e administruara gjate shqyrtimit gjyqësor si : deklarata e te dëmtuarës ne cilësinë e dëshmitarit dhënë ne shqyrtimit gjyqësor te dt. 25.01.2017, vendimi i formës se prere HPCCDS302633 i dt.27.06.2003, vendimi mbi kërkesën e shqyrtuar HPCC/REC/58/2006 dt.18.02.2006, kërkesa e PTH ne Gjakovë PP.nr.1717/13 të dt.22.05.2014, përgjigje nga AKP dt. 27.05.2014, kërkesa për ri posedim DS nr.302633 e dt.07.07.2005 si dhe nga vete deklarimi i të akuzuarit të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor.

E dëmtuara në cilësinë e dëshmitares Z. B., gjatë dëshmisë së saj të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor me dt. 25.01.2017, gjate shqyrtimit gjyqësor fillimisht ne pyetjet e parashtruara nga ana e prokurorit te shtetit ka deklaruar se ne këtë banese ka jetuar nga viti 1980 e gjere ne vitin 1999, e kur jemi larguar nuk kemi bere marrëveshje gojore a po me shkrim me askënd për shfrytëzimin e kësaj banese e as me te akuzuarin M. Z. Menjëherë jam njoftuar se i akuzuari është vendosur ne banesën time, kam thirre disa here ne telefon por nuk me është përgjigjur asnjëherë. Ne pyetjen e prokurorit se a keni provuar me arritur marrëveshje për shitblerje te kësaj paluajtshmerie me te akuzuarin ?, dëshmitarja ka deklarua se po kemi provuar por këta i kanë larguar blerësit tjerë te mundshëm, jam drejtuar personalisht zyrës se Habitatit, mirëpo edhe pasi qe janë dëbuar e kanë thyer derën dhe kanë hyre brenda ne banese duke iu drejtuar se unë jam marr vesh me te dëmtuarën Z. B.. Nga ajo kohë me nuk kemi pasur asnjë lloje komunikimi me te akuzuarin. Ne pyetjet e parashtruara nga ana e perf. te autorizuar te dëmtuarës av. V. A., dëshmitarja- e dëmtuara ka deklaruar se kemi pasur orendi ne banese por nuk e di sa është vlere, jetojë me qira si refugjate, jam e operuar nga karcinoma, gjithashtu edhe fëmijët e mi jetojnë me qira, nuk do te kthehem ne Gjakovë, e dëshirojë ta shes banesën e qe deri tani nuk kam mundur ta shes pasi qe ata janë ne banës dhe kanë larguar te interesuarit për blerje te banesës qe 18 vite, e unë nuk kam marr asnjë cent nga i akuzuari. Ne pyetjen e parashtruar nga ana e te akuzuarit se a është e vërtet se ia ke dhënë çelësat e banesës bashkëshortes sime ?,dëshmitarja –e dëmtuara ka deklaruar se nuk është e vërtet .

Nga vendimi i garantuar HPCC/DS302633, dt.27.06.2003, konstatohet se paraqitësit te kërkesës B. Z., i është dhënë posedimi mbi pronën, objekt kërkesë banesa e cila gjendet ne rrugën “Kosta Novakoviç”nr.7/14 ,ndërtesa “Orize “ kat.IV ,ne sip. 39.97m², KK Gjakovë.

Nga vendimi HPCCREC/58/2006, dt.18.02.2006, është refuzuar kërkesa për rishqyrtim duke mbetur ne fuqi vendimi i shkalles se I-re HPCCDS302633 dt. 27.06.2003.

Nga vendimi HPCCREC/58/06, dt. 07.06.2006, AKP-ja ka bere ekzekutimin e dëbimit nga prona e te akuzuarit M. Z.

I akuzuari M. Z., gjate mbrojtjes se tij te dhënë gjate shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se e kundërshton ne tërësi aktakuzën me qene se nuk ka te beje fare me veprën penale te uzurpimit te banesës kontestuese ngase banesa ne fjalë na është lëshuar nga ana e vete te dëmtuarës Z. B., e cila ia ka dhënë çelësat bashkëshortes sime V., te cilën banës akoma e kemi ne shfrytëzim ne pamundësi te vendstrehimit tjetër, por ne momentin kur unë do te beje zgjidhje do te ia lirojë edhe banesën. Gjithashtu shtojë se edhe pas dëbimit nga Habitati bashkëshortja ime ka komunikuar ne telefon me te tani te dëmtuarën e cila i ka thënë se nuk ka kush pune me banesën time dhe për këtë arsye jemi kthyer ne banës. Në pyetjet e parashtruara nga ana e prokurorit te shtetit se ne çfarë baze jeton ne atë banës dhe a paguani qira pronarit te banese pasi qe jeton edhe sot e kësaj dite ?, i akuzuari ka deklaruar se jo nuk paguaj qira dhe se nuk me ka kërkuar te paguaj qira, por, ka thënë ju rrini ne banës deri sa unë te kthehem apo ta shes. Ne pyetjen e parashtruara nga ana e prokurorit se çka kane vepruar punëtorët e Habitatit ditën e dëbimit ?, i akuzuari deklaroi se na kanë dëbuar nga banesa, dhe gjësendet e banesës i kanë hedhur jashtë, kanë mbyllur derën me letër te cilën e kanë postuar ne hyrje te banesës, por pas dy apo tri ditësh jemi rivendosur ne banës. Ne pyetjen e parashtruara nga ana e prokurorit se a mund te na përshkruani se si keni vepruar te hyni ne banës?, i akuzuari është përgjigjur se pari bashkëshortja e ka pyetur pronarin ne telefon dhe i ka treguar se janë dëbuar nga Habitati , ajo na ka thënë se nuk ka kush pune me banesën time, e kemi thyer bravën dhe jemi futur brenda. Në pyetjen e parashtruar nga ana e për. te autorizuar te dëmtuarës se si i paguani faturat dhe në emër të kujt paguhen ? i akuzuari ka deklaruar se faturat gjegjësisht kur jam paraqitur për te bere pagesat e shpenzimeve ne përgjithësi tek organet kompetente me kanë thënë se çdo pagese duhet te behet ne emër personal, pasi qe pronari nuk gjendet këtu .

Gjykata ka vlerësuar dhe analizuar pretendimet e prokurorisë të parashtruara si në aktin akuzues ashtu edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor , pretendimet e të akuzuarit gjatë mbrojtjes së tij , dëshmisë së të dëmtuarës në cilësi të dëshmitares si dhe të gjitha provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe ka konstatuar se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë dhe formohen të gjitha elementet e veprës penale uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.1 të KPRK-ës.

Gjykata ka konstatuar se dëshmia e te dëmtuarës - dëshmitares Z. B. përputhet me provat e administruara gjate shqyrtimit gjyqësor gjegjësisht vendimit HPCCDS302633 dt.27.06.2003, ku paraqitëses se kërkesës i është dhënë posedimi mbi pronën qe është objekt i kësaj vepre penale dhe se sipas vendimit te formës se prere HPCCDS302633 te dt. 18.02.2006 është refuzuar kërkesa për rishqyrtim duke lënë ne fuqi vendimin e shkalles se I-re HPCCDS 302633 te dt. 27.06.2003dhe nga ana e kësaj agjencie i akuzuari është dëbuar nga banesa por i njëjti prapë është kthyer dhe e shfrytëzon banesën në fjalë.

Gjykata ka vlerësuar dhe analizuar pretendimet e të akuzuarit M. Z., të dhënë në mbrojtjen e tij cili ka theksuar se për banesën nuk paguaj qira dhe se nuk me ka kërkuar te paguaj qira, por ka thënë ju rrini ne banës deri sa unë te kthehem apo ta shes. Është e vërtet se Habitati na kanë dëbuar nga banesa dhe gjësendet e banesës i kanë hedhur jashtë, kanë mbyllur derën me letër te cilën e kanë postuar ne hyrje te banesës, por pas dy apo tri ditësh jemi rivendosur ne banës, pasi bashkëshortja e ka pyetur pronaren ne telefon dhe i ka treguar se janë dëbuar nga Habitati .Ajo na ka thënë se nuk ka kush pune me banesën time, andaj ne kemi thyer bravën dhe jemi futur brenda. Gjykata konstatoi se të njëjtat janë të pa bazuara , të pa argumentuara në asnjë provë apo dëshmi të vetme dhe se e ka konsideruar vetëm përpjekje e të akuzuarit për të ju shmangur apo ikur përgjegjësisë penale.

Gjykata nga provat e administruara ka konstatuar si jokontestues faktin se i akuzuari M. Z., me veprimet e veta ka kryer veprën penale uzurpim i paligjshëm i pronës se paluajtshme nga neni 332/1 te KPRK-ës , duke hyre ne objektin e banimit ne te cilën nuk ka kërkuar ndonjë te drejte te banimit, te drejtën e shfrytëzimit pa pëlqimin e pronarit legjitim apo mbi ndonjë veprim ligjore juridik e te cilën prone akoma e shfrytëzon, .

Me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarit, Gjykata ka marr për bazë te gjitha rrethanat nga neni 73 te KPRK-ës qe ndikojnë ne zbutjen apo ashpërsimin e dënimit, dhe përpos konstatimit të kryerjes se veprës penale gjykata nuk ka gjetur rrethana posaçërisht renduese për te akuzuarin me qene se i njëjti i është përgjigjur ne mënyrë te rregullt ftesësve te gjykatës kurse si rrethanë lehtësuese për te akuzuarin e ka marr për bazë personalitetin e te akuzuarit, gjendjen e varfër ekonomike-shfrytëzues i ndihmave sociale, faktin se i njëjti me pare nuk ka qene i dënuar ,te cilat rrethana ndikuan qe gjykata duke pasur parasysh rrezikshmërinë e saj ka zbatuar disopozitat e zbutjes se dënimit dhe te akuzuarit ia ka shqiptuar dënimin me burgim ne kohëzgjatje prej 6(gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit ne afatin prej 1(një) viti nuk kryen ndonjë tjetër penale si dhe detyrimin të lirojë banesën-paluajtshmërinë e cila ndodhet ne lokacionin “Orize 11” kat. IV, në sip. 39.97m²,dhe e njëjta ti dorëzohet pronarit Z. B. nga Gjakova, me bindje se edhe me këtë dënim do te arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 te KPRK-ës.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marr komfor nenit 463 par. 2 të KPPK-së, pasi qe gjykata gjate shqyrtimit gjyqësor nuk ka mundur te saktësojë lartësinë e demit qe i akuzuari i ka shkaktuar te dëmtuarit pasi qe nuk ka asnjë ekspertizë apo konstatim për lartësinë e demit te shkaktuar.

Vendimi që shpenzimet e procedurës penale të bien ne barrën e mjeteve buxhetore, gjykata e morri ne mbështetje te nenit 453/4 te KPP-ës , pasi qe i akuzuari është shfrytëzues i ndihmave sociale e detyrimi qe ti paguajnë shpenzimet procedurale do te rrezikonte gjendjen materiale te akuzuarit ose të personave që ajo detyrohet ti mbështes materialisht.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr. 84/15 më datë 25.01.2017.**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë ,në afat prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,**Gjykatës së Apelit në Prishtinë**.Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate